



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 3.12.2019

Dokument parlamentar

(Komision përgjegjës)

R A P O R T

PËR AKTIN NORMATIV NR. 4 DATË 30.11.2019 “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 92/2014, “PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”

I. Hyrje

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 3.12.2019, mori në shqyrtim Akti Normativ nr. 4 datë 30.11.2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, bazuar në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Për shqyrtimin e këtij projektligji u caktua relator Z. Arben Ahmetaj.

Për të prezantuar projektligjin në emër të Qeverisë, ishin të pranishëm Znj. Anila Denaj Ministër i Financave dhe Ekonomisë si dhe përfaqësues të Ministrisë së Mbrojtjes.

II. Baza ligjore Kushtetuese

Akti normativ është propozuar nga Këshilli i Ministrave në përputhje me nenin 101 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Akti normativ shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68, të Rregullores së Kuvendit.

III. Qëllimi dhe përmbajtja e aktit normative.

Qëllimi

Përmes këtij akti normativ, bëhen disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me qëllim përjashtimin nga detyrimi i pagimit të tatimit mbi vlerën e shtuar për materialet dhe pajisjet e importuara nga organe shtetërore në rastet e shpalljes së “gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, për atë kohë sa është përcaktuar afati specifik për këtë qëllim si dhe për mallrat dhe pajisjet për qëllime ushtarake dhe që përdoren si armë, municion apo bazë materiale luftarake dhe të cilat janë projektuar, zhvilluar, prodhuar, montuar apo modifikuar për përdorim ushtarak, që importohen në emër të Ministrisë së Mbrojtjes.

Gjithashtu përmes këtij akti normativ, shmangen barrierat financiare për importimin e mjeteve dhe pajisjeve ushtarake që do të importohen nga vende të NATO-s dhe vendeve të tjera aleate, përfshirë rastet e gjendjes së jashtëzakonshme, duke ndryshuar kështu skemën e TVSH-së për këto pajisje duke kaluar nga skema e rimbursimit në atë të përjashtimit.

Përmbajtja e aktit normativ

Akti normativ përbëhet nga 3 nene gjithsej.

- Neni 1 i projektligjit shton në nenin 56 të tij, gamën e përjashtimeve në import për:
 - materialet dhe pajisjet e importuara për këtë qëllim nga organe shtetërore për rastet e shpalljes së “gjendjes së fatkeqësisë natyrore” brenda afatit të përcaktuar
 - mallrat dhe pajisjet për qëllime ushtarake dhe që përdoren si armë, municion apo bazë materiale luftarake dhe të cilat janë projektuar, zhvilluar, prodhuar, montuar apo modifikuar për përdorim ushtarak, që importohen në emër të Ministrisë së Mbrojtjes.
- Neni 2 parashikon shfuqizimin e fjalisë së dytë të pikës 2, të nenit 77, duke ndryshuar skemën e TVSH-së për importimin e mjeteve dhe pajisjeve ushtarake që do të importohen nga vende të NATO-s dhe vendeve të tjera aleate, duke kaluar nga skema e rimbursimit në atë të përjashtimit.
- Neni 3, akti normativ parashikon hyrjen e menjëhershme në fuqi të tij dhe detyrimin për botim në “Fletoren zyrtare”.

IV. Efektet financiare

Akti normativ nuk vlerësohet të ketë efekte financiare

V. Shqyrtimi i projektligjit në komision.

Relatori i Komisionit, në fjalën e tij u shpreh se akti normativ i propozuar nga Këshilli i Ministrave ka mundësuar krijimin e disa lehtësi fiskale për qëllime të interesit të lartë publik (mbrojtjes kombëtare dhe civile), të dedikuara fushës së përgjegjësisë së Ministrisë së Mbrojtjes, e cila ka një rol tepër të rëndësishëm edhe në rastet e emergjencave civile apo gjendjeve të jashtëzakonshme.

Nisur nga situata ku ndodhemi, të gjithë vendet aleate kanë kontribuar me mjete materiale të ndryshme, për të ndihmuar në përballimin e gjendjes së krijuar nga pasojat e tërmetit dhe rindërtimin e zonave të dëmtuara dhe për këtë arsye akti normativ ka shmangur pengesat ligjore që lidheshin me nevojën për buxhet shtesë të Ministrisë së Mbrojtjes për të mundësuar importimin e këtyre mallrave.

Arsyetimi i nevojës dhe urgjencës.

Kjo nismë ligjore e Qeverisë e cila shoqërohet edhe nga 3 akte normative të tjera, është ndërmarrë për shkak të situatës së krijuar pas tërmetit 6.4 të shkallës Rihter, që goditi Shqipërinë në datën 26.11.2019, dhe në kushtet kur Qeveria përmes vendimit nr.750, datë 27.11.2019, ka shpallur gjendjen e fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Lezhë dhe Tiranë, të cilat janë edhe qarqet e prekura nga kjo fatkeqësi natyrore.

Akti normativ është në përputhje me nenin 101 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cili ka vlerësuar mundësinë e prezencës së rrethanave specifike të “nevojës” dhe “urgjencës”, duke përcaktuar se: *“Këshilli i Ministrave, në rast nevoje dhe urgjence, nën përgjegjësinë e tij, mund të nxjerrë akte normative që kanë fuqinë e ligjit, për marrjen e masave të përkohshme. Këto akte normative i dërgohen menjëherë Kuvendit, i cili mblidhet brenda 5 ditëve nëse nuk është i mbledhur. Këto akte humbasin fuqinë që nga fillimi, në qoftë se nuk miratohen nga Kuvendi brenda 45 ditëve.”*

Akti normative, nr. 4, datë 30.11.2019 “Për një shtesë në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, aktualisht është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 161 datë 30.11.2019 dhe Kuvendi është brenda afateve Kushtetuese për ta shqyrtuar atë.

Situata tepër e vështirë në të cilën ndodhemi pas tërmetit të 26 nëntorit 2019 dhe detyrimi i shtetit për të ndërmarrë përgjegjësitë e tij dhe për këtë shkak edhe masa urgjente për tu ardhur në ndihmë të prekurve nga tërmeti, janë tregues që nuk kanë nevojë për tu analizuar më tej për të provuar se ndodhemi përpara kushteve të nevojës dhe urgjencës dhe për rrjedhojë edhe të plotësimit të gjitha kushtëzimeve të nenit 101 të Kushtetutës.

Miratimi i aktit normativ, nga Këshilli i Ministrave, ka shkurtuar së ndjeshmi kohën e ndërhyrjes së qeverisë në ndërmarrjen e masave për përballimin e situatës në të cilën ndodhemi aktualisht. Në rast se nisma do të paraqitej si një projektligj i propozuar nga Këshilli i Ministrave, në rrugë normale, koha në dispozicion të Kuvendit për ta miratuar atë si dhe procedurat e mëtejshme të parashikuara në Kushtetutë për miratimin dhe hyrjen në fuqi të aktit do të vononin së tepërmi ndërmarrjen e masave emergjente dhe të nevojshme për qytetarët.

Diskutimet në komision

Pas dëgjimit të relatorit të çështjes dhe shpjegimeve të dhëna nga Ministri i Financës dhe Ekonomisë, anëtarët e komisionit, shprehën vlerësimin e tyre lidhur me aktin normativ dhe domosdoshmërinë për mundësimin sa më shumë të jetë e mundur të lehtësirave si dhe gjetjes së mënyrave dhe lehtësive fiskale që ndikojnë në rehabilitimin e pasojave të tërmetit.

Kjo iniciativë është në përputhje edhe me frymën e transmetuar përmes nenit 59 të Kushtetutës lidhur me objektivat social të tij.

VI. Përfundime

Për gjithë sa më sipër analizova, duke vlerësuar se miratimi i këtij akti normativ, ishte nevojë dhe urgjencë e Qeverisë për mundësimin e disa lehtësive fiskale të dedikuara fushës së përgjegjësisë së Ministrisë së Mbrojtjes, për qëllim që më pas do të mund të përdoren për tju ardhur në ndihmë të dëmtuarëve nga tërmeti i 26 nëntorit 2019, me votat pro të gjithë anëtarëve të pranishëm, e miratoi aktin normativ nr. 4 datë 30.11.2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

RELATOR

Arben AHMETAJ

KRYETAR

Arben AHMETAJ